



Prishtinë: 10.12.2020
Kodi i ZRRE-së: V_1332_2020

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, Neni 15, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.2 dhe paragrafi 7, nën-paragrafi 7.2, Neni 26, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.2 dhe 28 i Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Neni 3, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.49 dhe nën-paragrafi 1.76, Neni 22, paragrafi 7, Neni 23, nën-paragrafi 5 dhe Neni 23.9, nën-paragrafi 9.3, 9.13, 9.14, 9.15 dhe 9.16 i Ligjit për Energjinë Elektrike (Nr. 05/L-085);
- Neni 11.5.2 i Rregullat e Tregut, të miratuara me Vendimin V_1066_2018, të datës 30 Tetor 2018, nga Bordi i ZRRE-së;
- Neni 3.5 i Licencës së Operatorit të Tregut të Energjisë Elektrike të lëshuar për Operatorin e Sistemit, Transmisionit dhe Tregut (KOSTT) Sh.A. me numër regjistrimi: ZRRE/Li_16/17;
- Kërkesën e datës 16 Nëntor 2020 të dorëzuar nga KOSTT për miratim në parim nga Bordi i ZRRE-së në lidhje me të drejtën e KOSTT-it për caktimin dhe/ose transferimin e të drejtave dhe detyrimeve tek ALPEX për organizimin e tregut një ditë përpara dhe gjatë ditës për territorin e Republikës së Kosovës.

në seancën e mbajtur me datë 10 dhjetor 2020, nxori këtë:

VENDIM

- I. Aprovim në Parim – i kërkesës së KOSTT për të caktuar dhe/ose transferuar disa të drejta dhe obligime tek ALPEX për organizimin e tregut një ditë përpara dhe gjatë ditës për territorin e Republikës së Kosovës.**
- II. KOSTT, si bartës i Licencës ZRRE/Li_16/17, është i obliguar të fillojë negociatat për marrëveshjen e shërbimeve me një palë të tretë për të organizuar tregun një ditë përpara dhe gjatë ditës për territorin e Republikës së Kosovës.**
- III. Marrëveshja e shërbimeve e cekur në Nenin II. të këtij Vendimi duhet të përmbajë disa të drejta dhe detyrime që KOSTT i ushtron bazuar në: (i) Ligjin për Energji Elektrike (Nr. 05/L-085); (ii) Licencën ZRRE/Li_16/17; (iii) Rregullat e Tregut; dhe (iv) legjislacionin tjetër dytësor në lidhje me organizimin e tregut një ditë përpara dhe gjatë ditës për territorin e Kosovës;**
- IV. KOSTT duhet të ndajë draftin final të marrëveshjes së shërbimeve me ZRRE-në për komentim.**
- V. Pas finalizimit dhe nënshkrimit të marrëveshjes së shërbimeve KOSTT duhet që formalisht të kërkojë nga Bordi i ZRRE-së që të caktoj dhe/ose transferoj ndonjë të drejtë të cilën e bartë KOSTT, në përputhje me Nenin 3.5 të Licencës ZRRE/Li_16/17.**



Arsyetim

ZRRE me datë 16 Nëntor 2020 ka pranuar një kërkesë nga KOSTT për miratim në parim nga Bordi i ZRRE-së në lidhje me të drejtën e KOSTT-it për caktimin dhe/ose transferimin të disa të drejtave dhe detyrimeve tek ALPEX për organizimin e tregut një ditë përpara dhe gjatë ditës për territorin e Republikës së Kosovës.

Kërkesa ofroi sqarime në lidhje me bazën ligjore:

- E cila e bën KOSTT-in si Operator Tregut përgjegjës për organizimin e tregut një ditë përpara dhe gjatë ditës për tërë territorin e Kosovës;
- Në lidhje me të drejtën e Operatorit të Tregut të përcaktojë Bursën e Shqipërisë (Albanian Power Exchange) si një Treg të Organizuar të Energjisë Elektrike për qëllime të tregtimit një ditë përpara dhe/ose brenda ditës, sipas Rregullave të Tregut;
- Për të drejtën e ZRRE-së për të aprovuar transferimin e të drejtës për të caktuar dhe/ose transferuar të ndonjë të drejte ose obligimi tek një palë e tretë.

KOSTT-i është zgjedhur aksionar i Bursës së Shqipërisë (Albanian Power Exchange) ALPEX i themeluar në Shqipëri, si një entitet përgjegjës për menaxhimin dhe administrimin e tregut,, të organizuar përmes një platforme të tregut, i cili do të operojë në fushën e shkëmbimit të energjisë elektrike në mes të tregjeve të Shqipërisë dhe Kosovës.


VI. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës.

VII. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i Zyrës së Rregullatorit dhe do të publikohet

VIII. në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund t'i drejtohet Gjykatës Kompetente brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të vendimit në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së


Arsim Janova, UD Kryesues


Besim Beqaj, Anëtar


Selman Hoti, Anëtar


Izet Rushiti, Anëtar

Vendimi i dërgohet:

- Të licencuarit – KOSTT SH.A.,
- Arkivit të ZRRE